



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2018:066736

Datë: 30.05.2019

Numri i dokumentit: 00337272

P.nr.1821/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, gjyqtarja Arjeta Gashi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Afërdita Kicaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit B.M nga rruga “....”nr.....-...., për shkak të veprës penale, blerja, ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 par.2. të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.II.nr.791-8/18 të datës 13.11.2018, në seancën publike në prezencën e Prokurorit të Shtetit Shehadin Destani, i akuzuari B. M., me datë 16.05.2019, mori dhe shpalli, ndërsa përpiloi me datën 23.05.2019 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. M nga i ati N. M dhe e ëma V., e lindur K, i lindur me datë, në në rrugën “....”, nr.....-, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa martuar, shqiptarë, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal të letërnjoftimit 1249028335.

ËSHTË FAJTOR

Se në muajin shkurt të vitit 2018, në, në lokalitetin “....”, i pandehuri blen telefonin e markës “...”, me numër të, nga një person i panjohur dhe më pas të njëjtin telefon e ndërron me një telefon “....”, në dyqanin e telefonave mobil “....”, në, edhe pse i pandehuri ka mundur ta dijë se ky telefon është përfituar me kryerjen e veprës penale, i cili telefon, me datë 07.02.2018, i ishte vjedhur të dëmtuarës M. A.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, blerja ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 para.2. i KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7,8,9,41,par.1 nën para. 1.2. neni 49 par.1 nënpara.1.1. neni 50,51,52 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPPK-së.

Të akuzuarit B.M ia shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara M. A. nga, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I akuzuari obligohet që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 20€, po ashtu bazuar në nenin 39 parag. 3 pika 1 të Ligjit nr.05/L-036 , të akuzuarit i caktohen 30 euro taksë në emër të kompensimit të viktimave të krimit, të gjitha këto obligohet që të i paguaj, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.791-8/2018 të datës 13.11.2018, kundër të akuzuarit B.M nga rr. ”....” nr....., për shkak të veprës penale – blerja ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale nga neni 345 para. 2 të KPRK-së.

Gjykata lidhur me këtë çështje penale ka caktuar dhe mbajtur shqyrtim fillestar, në prezencën e palëve është lexuar aktakuza nga prokurori. I akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën dhe e pranoj fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë dhe provueshmërinë e provave, e ndej veten fajtor, dhe se për këtë jam penduar është hera e parë që ballafaqohem me ligjin, më vije keq për çka ka ndodhur, mirëpo nuk e kam ditur që telefoni ka qenë i vjedhur, në lokalin ku unë kam qenë kane ishin tre nxënës të cilët bëjshin pazar për një telefon, çmimi mu duk i arsyeshëm dhe e bleva 280 euro, këtë telefon e kam përdorur dy javë dhe më pas jam njoftuar nga policia që ky telefon ka qenë i vjedhur, po ta dija nuk do ta kisha blerë. I premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe nuk do të kryej vepra penale

Prokurori i Shtetit ka konsideruar se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nuk e ka kundërshtuar pranimin e te njëjtës, pasi që pranimi i fajit është bere në mënyre vullnetarë nga ana e te pandehurit dhe se pranimin gjënë mbështetje ne faktet e [çështjes qe përmban aktakuza.

Sa i përket gjendjes faktike konsiderohet se ajo është vërtetuar plotësisht si në përshkrimin faktik të aktakuzës nën kushtet dhe rrethanat ligjore të pranimit të fajësisë.

Gjykata gjendjen faktike e ka vërtetuar nga vetë pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat. Gjykata sipas detyrës zyrtare ka gjetur se nuk ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, po ashtu në tërësi është vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë dhe ky pranim është bërë pa kushtëzim dhe vullnetarisht nga ana e tij, dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova të çështjes që përmban aktakuza dhe se i akuzuari në këtë shqyrtim ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale, të cilat i ka paraqitur përfaqësuesi i aktakuzës dhe të cilat asnjëherë

nuk i ka kundërshtuar dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, se i njëjti ka shpreh keqardhje dhe ka premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej veprime të kundërligjshme si dhe qëndrimin e tij korrekt gjatë procesit gjyqësor. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij dhe ky dënim i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se shqiptimi i dënimit të tillë do të ndikojë që i akuzuari të përmbahet nga veprimet kundërligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 dhe 453 para.1 të KPPK-së.

Vendimin për programin e kompensimit të viktimave të krimit është marrë në kuptim të nenit 39 pra.3 pika 1. të Ligjit me numër 05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2018:066736, 30.05.2019

G j y q t a r j a

Arjeta Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.